

Intervistë me

Vase Jovevski


Drejtor në ORrT

(Operatori i sistemit elektrotransmetues)

Gratë në energjetikë

Magdalena Sekulovska

Elektroinxhinierë



RRJETI
STABIL,
ENERGJIA E
SIGURT

PËRMBAJTJA

AKTUALITET 4

INTERVISTE 8

PROJEKTE 13

STACIONI I TRANSFORMUESIT 21

GRATË NË ENERGJETIKË 24

NJË DITË ME EKIPIET E MEPSO 27

KONFERANCA /DEBATE 29

DEKLARATA SHKUP 30

PUNONJËSIT DHE MEPSO 32

LAJME NGA BOTA 34

20 MEPSO VJET

Botuar nga Sha MEPSO

Rruga Maksim Gorki nr.4.Shkup
Republika e Maqedonise se Veriut
www.mepso.com.mk

Drejtori Gjeneral:

Prof. d-r Burim Latifi

Pergatitja teknike:

Irina Daskalovska Qosevska

Violeta Z. Stojanovska

Emine Abazi Gashi

Zamir Mehmed

Selviye Ramani

AKTUALITETE

14.FORUMI NDËRKOMBËTAR PËR ENERGJI DHE ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM- IFESD-14

Përvoja e deritanishme dhe vizioni për të ardhmen e sistemit elektrotransmetues

Shkupi në tetor për tri ditë rradhazi ishte qendër globale e vizionit energjetik dhe dialogut për zhvillim të qëndrueshëm. Edicioni i katërmëdhjetë i Forumit botëror bashkoi më shumë se 500 pjesëmarrës nga 70 vende, me mbi 150 folës që përmes 35 seancave dhe paneleve tematike ndanë ide, zgjidhje dhe propozime konkrete për hapat e ardhshëm në tranzicionin global energjetik. Mesazhi kryesor i forumit ishte i qartë: të kalojmë nga qëllimet globale në veprime konkrete, me masa të qarta të përcaktuara për diversifikimin e burimeve, përshejtimin e investimeve në burime të ripërtëritshme dhe bashkëpunim të shtuar rajonal. Në kushte kur stabiliteti energjetik po bëhet faktor gjithnjë e më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik, rezistenca e sistemeve elektroenergjetike merr rëndësi të veçantë. Pikërisht në këtë kontekst, në panelin e diskutimit "Lidhshmëria energjetike, rezistenca dhe siguria", drejtori gjeneral i ShA MEPSO, prof.dr Burim Latifi theksoi se rezistenca, fleksibiliteti dhe koordinimi janë parime themelore për funksionim të sigurt dhe të besueshëm të sistemit elektroenergjetik.



"Qëllimi nuk është vetëm të analizohen sfidat, por të nxirren mësimet konkrete që do ta bëjnë rrjetin e transmetimit më të fortë dhe më rezistent ndaj rreziqeve të ardhshme. Përballja me tensione të larta dhe ngarkesa të ndryshueshme kërkon masa parandaluese në afat të shkurtër dhe zbatim të zgjidhjeve robuste afatgjatë. Vizioni i MEPSO-s është i qartë: zhvillim i infrastrukturës inteligjente, të integruar ndërsektorialisht dhe klimatisht neutrale, e përgatitur për epokën e re të elektrifikimit", theksoi Latifi.



"Çdo euro e investuar sot në efikasitet energjetik dhe burime të ripërtëritshme është investim në një bashkësi më të shëndetshme, biznese më konkurruese dhe rezistencë strategjike nesër. Me rregulla të harmonizuara, financim dhe zbatim, ambiciet i shndërrojmë në projekte që në mënyrë të matshme ulin faturat dhe emetimet?", deklaroi ministrja Bozhinovska.

Në kuadër të forumit u nënshkrua "Deklarata e Shkupit", si regjistër i përhershëm i angazhimeve të vendeve pjesëmarrëse drejt një të ardhmeje energjetike të qëndrueshme, të sigurt dhe inkluzive. Organizator i forumit ishte Ministria për Energjetikë, Miniera dhe lëndë të para, në bashkëpunim me UNDP-në dhe komisionet rajonale të OKB-së (UNECE, UNESCSP, UNECLAC, UNECA и ESCWS).

AKTUALITETE

MEPSO BËHET PJESË E FAMILJES SË SHTËPISË SË VETME UNIKE TË ALOKIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN – JAO, ME SELI NË LUKSEMBURG

Pas disa muajsh pune dhe koordinimi të Departamentit për menaxhimin e rrjetit elektrotransmetues, nga Njësia e OST-së me operatorët e sistemeve fqinje nga Republika e Bullgarisë dhe Republika e Serbisë, nga njëra anë, dhe Shtëpia Unike e alokimit të Bashkimit Evropian – JAO, u finalizua projekti për alokimin e mëtejshëm të kapaciteteve në kufijtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut me këto dy vende fqinje.

Kjo do të thotë se nga 1 janari 2026, alokimet afatgjata (vjetore dhe mujore) dhe alokimet afatshkurtra (ditore), do t'i kryejë Shtëpia unike e alokimit të Bashkimit Evropian – JAO me seli në Luksemburg, e cila është zyra e vetme e njohur për alokimin e kapaciteteve në Bashkimin Evropian nga ENTSO-E.

JAO është një kompani shërbimi që pret platformën e vetme udhëheqëse të tregtimit në Evropë (e-CAT) për kapacitetin e transmetimit ndërkufitar. Në emër të operatorëve të sistemeve të transmetimit (TSO), JAO ankandon të drejtat e disponueshme afatgjata dhe afatshkurtra të kapacitetit të transmetimit në të gjitha kufijtë e brendshëm të BE-së. Gjithashtu, JAO organizon ankande hije, të cilat veprojnë si kopje rezervë për lidhjen njëditore paraprakisht (SDAC). Që nga 1 tetori 2018, JAO është Platforma unike e shpërndarjes (SAP) për të gjithë operatorët evropianë të sistemeve të transmetimit (TSO) që veprojnë në përputhje me legjislacionin e BE-së, pasi është në gjendje të zbatojë dhe përmbushë të gjitha detyrimet dhe kërkesat rregullatore.

Procesi i përgatitjes për ndarjen e kapaciteteve për alokim me operatorët e sistemeve fqinje nga Republika e Bullgarisë dhe Republika e Serbisë, u udhëhoq nga drejtuesit e OEPSE dhe zgjati gati një vit. Filloi me harmonizimin me EMS dhe ESO për braktisjen e mënyrës së deritanishme të kryerjes së alokimeve të kapaciteteve në mënyrë bilaterale me marrëveshje dhe softuerë të ndërsjellë. Pastaj u kalua në Kërkesën për qasje në JAO dhe përdorimin e shërbimeve të alokimit të kësaj zyre. Pasi u formalizua bashkëpunimi, ekipet nga tre operatorët iu qasën harmonizimit të Rregullave të alokimit dhe përgatitjes teknike të sistemeve përkatëse për shkëmbimin e informacioneve me platformën e JAO-s.



Shareholders



Për këtë qëllim, në shtator në MEPSO ishin të pranishëm përfaqësues dhe personel teknik nga EMS, e më pas edhe nga ESO për harmonizimin e marrëveshjeve, përgatitjen e anekseve në Marrëveshjet për tregtinë ndërkufitare me kapacitete. Kusht për aderimin e MEPSO-s në JAO është edhe miratimi i Rregullave të harmonizuara të alokimit (Harmonised Allocation Rules), të pranuar nga ACER, e më pas të miratuara nga MEPSO, Komisioni Rregullator për Energjetikë, Shërbime të Ujit dhe Shërbime për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale dhe Ministria për Energjetikë, Miniera dhe Lëndë të Para Minerale. Marrëveshja HAR është harmonizuar me Rregulloren e Komisionit (BE) 2016/1719 për Alokimin e kapaciteteve afatgjata të 26 shtatorit 2016. Me këtë ligjërisht mundësohet

që minimum 70% e kapacitetit të transmetimit të jepet në ankande.

Testimi i shkëmbimit të skedarëve të të dhënave midis sistemeve të MEPSO-s dhe platformës së JAO-s ishte i suksesshëm dhe mbetet vetëm hapi i fundit i këtij procesi, që është miratimi nga Komisioni Rregullator për Energjetikë, Shërbime të Ujit dhe Shërbime për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale dhe Ministria për Energjetikë, Miniera dhe Lëndë të Para Minerale, i cili duhet të përfundojë deri në fund të nëntorit. Ndërkohë, pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike duhet të regjistrohen në platformën e alokimit, në mënyrë që të mund të marrin pjesë në ankandet vjetore, të cilat janë parashikuar të mbahen më 8 dhjetor 2025.



AKTUALITETE

U NËNSHKRUA MARRËVESHJE PËR RRJETIN MODERN DHE DIGJITAL TË TRANSMETIMIT



SHA MEPSO, Agjencia franceze për zhvillim (AFD) dhe RTE International nënshkruan një marrëveshje granti që siguron ndihmë teknike për modernizimin dhe dixhitalizimin e rrjetit të

transmetimit në vend. Projekti pilot për dixhitalizimin e një trafostacioni me sisteme të avancuara të mbrojtjes, menaxhimit dhe mbikëqyrjes përfaqëson një hap konkret drejt transformimit të MEPSO-s në një operator më të zgjuar dhe më efikas të sistemit të transmetimit. Qëllimi i projektit është të mundësojë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike, ulje të humbjeve teknike dhe integrim të rritur të burimeve të rinovueshme. Aktivitetet janë të drejtuara drejt përgatitjes së studimeve për përshtatshmërinë e sistemit duke përdorur simulatorin e tregut ANTARES, dimensionimin e rezervave sistimore, vendosjen e metodologjisë për llogaritjen e humbjeve të transmetimit, si dhe përgatitjen e dizajnit konceptual për dixhitalizimin e trafostacionit.

TS DUBROVË ME TRANSFORMATOR TË RI 400/110 kV



Është vënë nën tension transformatori i ri 400/110 kV me fuqi 300 MVA. Projekti u realizua nga ekipi profesional i njësitës ORT-së, në përputhje me dinamikën e planifikuar dhe të gjitha standardet teknike – nga transporti dhe montimi deri te testimi dhe lidhja. Kjo investim paraqet një hap të rëndësishëm në përmirësimin e infrastrukturës së transmetimit veçanërisht në kushtet e rritjes së konsumit të energjisë elektrike dhe integritetit të burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE).

Me transformatorin e ri, TS Dubrovë fiton besueshmëri dhe siguri më të madhe, e gatshme të përballë me sfidat e ardhshme dhe të mbështesë procesin e tranzicionit drejt energjisë së gjelbër.

INTERVISTË ME VASE JOVEVSKI, DREJTOR I NJESISË OPERATOR I RRJETIT TË TRANSMETIMIT(ORrT)

PËRVOJA E TË MOSHUARVE DHE ENERGJIA E TË RINJËVE-FORMULË FITUESE PËR ORrT-në



Në një kohë kur sektori energjetik po zhvillohet me ritme të përshpejtuara dhe po vendos standarde të reja për siguri, efikasitet dhe transparencë, roli i operatorit të rrjetit të transmetimit merr një rëndësi edhe më të madhe. Njësia ORrT-së brenda MEPSO-s është shtylla kryesore që siguron menaxhimin e qëndrueshëm, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, dhe në krye të saj qëndron Vase Jovevski – drejtor me përvojë të thellë profesionale dhe vizion të qartë për zhvillimin e ardhshëm të rrjetit.

Në këtë intervistë bisedojmë për prioritetet strategjike të ORrT-së, sfidat në menaxhimin e sistemit të transmetimit, rëndësinë e modernizimit dhe dixhitalizimit, si dhe rolin e kuadrit të ri profesional në transformimin e ardhshëm të energjetikës.

Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballlet ORrT-ja gjatë ndërtimit, mirëmbajtjes dhe modernizimit të linjave të transmetimit, sidomos kur flitet për plakjen e infrastrukturës?

- Kur flasim për rrjetin e transmetimit, mund të them lirshëm se linjat e transmetimit janë shtylla kurrizore e këtij sistemi dhe luajnë rol kyç për funksionim normal, të besueshëm dhe të pandërprerë. Duke marrë parasysh trendin global të implementimit dhe lidhjes së kapaciteteve të reja energjetike nga burimet e ripërtëritshme, Njësia ORrT përballlet me sfida teknike me qëllim përmirësimin e kapacitetit të transmetimit dhe forcimin e rrjetit në disa rajone. Për këtë arsye, në fokusin e kësaj njësie janë projektet që do të mundësojnë forcim të rëndësishëm të rrjetit të transmetimit dhe rritje të kapacitetit të linjave përmes intervenimeve rekonstruktive dhe përdorimit të pajisjeve speciale dhe përcjellësve speciale.

Me kënaqësi mund të veçoj projektet që në një afat të shkurtër do të mundësojnë forcimin e rrjetit në rajonin verior, përkatësisht linjat TS Kumanovë 1 – TS Kriva Rekë (Kratovo) – TS Probishtip, rekonstruktimin dhe rritjen e kapacitetit të linjës TS Shtip – TS Koçan, si dhe rekonstruktimin e plotë të linjave 110 kV në segmentin nga Gostivar deri në Manastir.

Sigurisht, për funksionim të pandërprerë të rrjetit të transmetimit rol kryesor ka edhe mirëmbajtja e objekteve energjetike, që në thelb përbën një pjesë të rëndësishme të punës së njësisë.

Duke pasur parasysh që punonjësit e ORrT-së shpesh punojnë në terrene të paarritshme, në lartësi të mëdha dhe në kushte të paparashikueshme moti, si e organizoni punën e sigurt dhe efikase të ekipeve? Cilat inovacione teknike apo praktika të reja po aplikoni për rritjen e sigurisë dhe efikasitetit në ndërhyrjet në terren?

- Pajtohem që procesi i mirëmbajtjes së linjave të transmetimit shoqërohet me sfida të caktuara që rrjedhin nga fakti se aktivitetet zhvillohen shpesh në terrene malore të paarrishme, punë në lartësi mbi shtyllat e linjave, në kushte të këqija atmosferike dhe gjatë natës.

Duke e pasur këtë parasysh, është imperativ të sigurojmë punë të sigurt dhe efikase që do të kujdeset pa pengesa për gjendjen dhe stabilitetin e rrjetit elektrik të transmetimit. Kjo kërkon para së gjithash përkushtim të madh ndaj punës, por edhe sigurimin e kushteve speciale për ekipet e linjave. Kjo arrihet përmes implementimit të mjeteve dhe pajisjeve të reja të modernizuara, si dhe trajnimeve të specializuara për punëtorët, që të jenë të njohur paraprakisht me sfidat që i presin.

Sa i përket llojit të pajisjeve dhe inovacioneve teknike, me kënaqësi mund të theksoj se Departamenti i Linjave, gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe inspektimit të linjave, përdor dronë speciale dhe automjete ATV 4x4 për lëvizje në terrene malore, çka mundëson qasje maksimale në çdo shtyllë apo segment të traseve të linjave. Kështu arrihet efikasitet më i lartë dhe ekzekutim i sigurt i detyrave.

Përveç kësaj, përdoret pajisje bashkëkohore për testim, matje të parametrave elektrikë, lokalizim të anomalive dhe defekteve, pajisje për punë në lartësi, kontroll termovizor IR, rezistencë të tokëzimit etj. Për kryerjen e punëve specifike dhe ndërhyrjeve, grupet e mirëmbajtjes përdorin pajisjet më moderne të mbrojtjes personale, pajisje kundër rënies dhe pajisje për evakuim të shpejtë dhe të sigurt nga vendi i punës.

Sa është i pranishëm përdorimi i teknologjive të reja dhe mjeteve dixhitale në mirëmbajtjen dhe monitorimin e përditshëm të gjendjes së rrjetit të transmetimit?

- Njësia ORrT ndjek trendin global dhe metodat e reja për modernizim dhe dixhitalizim të procesit të mirëmbajtjes dhe funksionimit të pandërprerë të linjave dhe nënstacioneve transformuese. Me implementimin e teknologjive të avancuara smart si sistemi i menaxhimit të aseteve (Asset Management System), që do të mundësojë dixhitalizim të plotë të procedurave dhe procesit të mirëmbajtjes dhe menaxhimit të pajisjeve, teknologjitë DLR etj.

Përveç kësaj, në fokus janë projektet e dixhitalizimit dhe sistemet online që do të instalojnë në linja të caktuara transmetuese, me çka do të mundësohet shfrytëzim i saktë i pajisjeve, rritje e besueshmërisë, shkurtim i kohës së nevojshme për sanim defektesh etj.



Në fokusin e Njesisë ORrT janë teknologjitë, mjetet dhe pajisjet më bashkëkohore, zgjidhje softuerike të specializuara, teknologji online të avancuara dhe inteligjencë artificiale e aplikuar. Me to do të mundësohet modernizim i plotë dhe monitorim online, si dhe menaxhim i rrjetit të transmetimit duke ndjekur trendin e zhvillimit të operatorëve të sistemeve transmetuese në rajon dhe në kuadër evropian. Për këtë flasin edhe projektet pilot që Njësia ORrT planifikon t'i realizojë shumë shpejt.

Si zhvillohet bashkëpunimi me operatorët fqinj, sidomos në situata krizash, por edhe për planifikim të përbashkët të projekteve, shkëmbim përvojash, trajnim kuadri etj.?

- Bashkëpunimi me operatorët fqinj zhvillohet vazhdimisht në frymën e partneritetit, duke pasur parasysh që kemi qëllim të përbashkët: sigurimin e një sistemi elektro-energetik stabil, të sigurt dhe të besueshëm.

Aq më tepër që MEPSO, ashtu si operatorët e tjerë fqinj, është pjesë e rrjetit të ENTSO-E.

Në situata krizash janë vendosur kanale të qarta komunikimi dhe koordinimi, që mundësojnë shkëmbim të shpejtë informacionesh dhe zgjidhje efikase të problemeve. Shkëmbimi i përvojave zhvillohet përmes takimeve të përbashkëta të grupeve punuese, ku diskutohen përvojat nga implementimi i teknologjive të reja për diagnostikim

dhe mirëmbajtje, burimet njerëzore dhe sfidat e ardhshme lidhur me ndryshimet klimatike.

Shembulli i fundit i një bashkëpunimi të tillë ishte pjesëmarrja e MEPSO-s përmes Njesisë ORrT në konferencën rajonale të operatorëve të transmetimit që u mbajt në tetor në Beograd, në organizim të EMS-së.



Atje morën pjesë operatorët nga Mali i Zi, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Sllovenia dhe natyrisht pritësi Serbia.

U bë një krahasim se ku ndodhet MEPSO krahasuar me operatorët e tjerë rajonalë në mirëmbajtje, diagnostikim, futjen e teknologjive të reja, projektet e ardhshme dhe mungesën e kuadrit të kualifikuar, si dhe konstatime se si duhet të funksionojë një operator modern transmetues – drejt të cilit synon të jetë MEPSO.

Lidhshmëria rajonale është prioritet gjithnjë e më i madh. Cilat projekte interkoneksioni me vendet fqinje e prekin drejtpërdrejt ORrT-në dhe cili është roli juaj në to?

- Sa i përket projekteve, puna natyrore e Njesisë ORrT është me linja transmetuese dhe nënstacione, prandaj të gjitha projektet që kanë të bëjnë me linja dhe nënstacione e prekin drejtpërdrejt ORrT -në. Veçanërisht të rëndësishme për ne dhe për shtetin janë projektet e lidhjes me operatorët fqinj, mirëmbajtja e linjave ekzistuese interkonektive dhe ndërtimi i nënstacioneve të reja.

Pjesëmarrja e punëtorëve të Njesisë ORrT në grupet punuese është me rëndësi kyçe, prandaj me plot gojën mund të themi se Njësia ORrT është forca lëvizëse, hallka kryesore dhe e pazëvendësueshme në zinxhirin e quajtur zhvillim, modernizim dhe stabilitet i sistemit elektro-energjetik të Maqedonisë.

Në kuadër të politikave evropiane energjetike, dixhitalizimit dhe integritimit të burimeve të ripërtëritshme – cili është roli i njesisë në tranzicionin drejt një sistemi energjetik më të qëndrueshëm?

- Në kuadër të politikave dhe objektivave evropiane për dekarbonizim, roli i Njesisë ORrT është të sigurojë zgjidhje për infrastrukturë energjetike moderne, të sigurt dhe mbi të gjitha fleksibël që mund të përgjigjet ndaj rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Kjo në praktikë do të thotë që për çdo kërkesë për lidhje në rrjetin e transmetimit të prodhuesve nga burime të ripërtëritshme, Njësia ORrT përmes shërbimeve përkatëse kryen analizë teknike dhe verifikim të mundësive për lidhje, lëshon kushte dhe zgjidhje teknike për lidhje, mbikëqyr ndërtimin e infrastrukturës lidhëse – linja, nënstacione, fusha linjash, mbrojtje dhe menaxhim bashkë me të gjitha testet për punë provuese, deri në vënien përfundimtare në punë të pikës lidhëse me tërë infrastrukturën.

Mirëmbajtja e mëvonshme e kësaj infrastrukture mbetet detyrë e MEPSO-s, përkatësisht e Njesisë ORrT. Duke pasur parasysh trendin e rritjes së kërkesave për lidhje, vëllimi i punës së Njesisë ORrT bëhet gjithnjë e më i madh.

Nga gjithçka e thënë më sipër, roli i Njesisë ORrT si pjesë e pandashme në procesin e integritimit të burimeve të ripërtëritshme në rrjetin e transmetimit është plotësisht i qartë.

Mungesa e kuadrit teknik është sfidë në të gjithë rajonin. Ku e lokalizoni shkakun e asaj që me kusht mund ta quajmë “mosinteresim” i të rinjve për punë, p.sh. si montues ose profesione të tjera teknike – kushtet, paga, rreziku apo diçka tjetër? Çfarë po ndërmerr konkretisht MEPSO për tërheqjen dhe mbajtjen e këtyre profileve? A ka hapësirë për futjen e profileve të reja të kuadrit teknik që do t'i përgjigjeshin kërkesave bashkëkohore të rrjetit? A ka hapësirë për avancim dhe ndërtim karriere në këtë fushë, apo ende shihet si punë “e rëndë” dhe “burrërore”?

-Në kushte kur tregu i punës dikton ndryshime dhe çekuilibër, pra kur kërkohet më shumë kuadër i kualifikuar sesa ofrohet, qasja ndaj profileve si inxhinierë, montues, elektroteknikë, bravandreqës, saldatorë dhe ekspertë IT është e vështirë për të gjitha kompanitë në Maqedoni, dhe MEPSO nuk bën përjashtim.

Shkaqet për këtë mungesë tashmë kronike janë të shumta dhe varen nga shumë faktorë: ulje e interesit për arsim profesional dhe drejtimet energjetike në fakultete, mos-përshtatje e programeve mësimore me nevojat e tregut, deri te ambienti dhe atmosfera jo e shëndetshme e punës.

Me gjithë këtë zvogëlohet motivimi për punë dhe rritet ikja e kuadrit të kualifikuar jashtë vendit në kërkim të kushteve më të mira



„Qëllimi im si drejtues i Njesisë ORrT është qasje e sinqertë dhe kolegjinale ndaj të gjithë punonjësve, duke vlerësuar para së gjithash punën dhe kontributin e të moshuarve dhe më me përvojë, dhe njëkohësisht duke dhënë mbështetje të fuqishme të rinjve përmes trajnimeve dhe përfshirjes në sa më shumë projekte që, përveç zhvillimit të MEPSO-s dhe Maqedonisë, nënkuptojnë edhe zhvillim individual dhe ngritje personale.”

Ekskluzivisht këtu dua të paralajmëroj se në planin e prokurimit publik për vitin 2026 do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë trajnimeve të punonjësve si kurrë më parë, si dhe blerjes së literaturës më bashkëkohore profesionale nga autorë botërorë në fushën e transformatorëve, mbrojtjes relé, linjave transmetuese, menaxhimit të projekteve etj.

Në këtë kontekst dua veçanërisht të theksoj trajnimin që nuk mund të merret me asnjë trajnim tjetër: transferimin e diturisë nga të moshuarit te të rinjtë – diçka që ende funksionon pa të meta në Njësinë ORrT dhe për çfarë jemi jashtëzakonisht krenarë.

Sa i përket pjesës së fundit të pyetjes, dëshiroj të theksoj se Njësia ORrT është e hapur për të gjithë ata që kanë dëshirë dhe duan të punojnë në sfida reale dhe praktike, të jenë pjesë e ekipit që kujdeset që sistemi të funksionojë gjithmonë pa të meta dhe të jenë në vijën e parë kur është më e vështirë, kur minutat dhe sekondat mund të jenë jetike, kur dituria mund të vlejë miliona.

Me një fjalë, çdo punonjës mund të ndihet pjesë e mozaikut të quajtur Njësia ORrT, ku çdokush mund të gjejë vendin e vet dhe të ndihet krenar dhe produktiv për atë që ka bërë.

Prandaj fraza “e rëndë dhe burrërore” është krejtësisht e saktë, por jo vetëm në kuptim fizik – është një parashikim i saktë, një ndërhyrje e saktë, një lexim dhe transmetim i saktë informacioni, një asistencë e saktë, një vizatim i saktë, një evidencë e saktë, një orar i saktë, një urdhëresë saktë, një “mirëmëngjes” i sinqertë në korridor, një kafe e pirë bashkë dhe shumëçka tjetër.

Ku e shihni njësinë në 5 deri 10 vitet e ardhshme – teknikisht dhe organizativisht? Cilat janë hapat kyç që duhen ndërmarrë për të arritur atë zhvillim?

-Para se të përgjigjem për të ardhmen e Njesisë OPM, mendoj se lexuesit, respektivisht punonjësit e ShA MEPSO, duhet ta dinë historinë e Njesisë që është themeluese e MEPSO-s. Pjesë e kolegëve më të vjetër e dinë, por ja edhe për të rinjtë: Njësia ORrT e meriton epitetin e njesisë kryesore organizative në përbërje të MEPSO-s.

Derisa në kuadër të ish-Elektrostopanstvës së Maqedonisë deri në vitin 2005 funksiononte Njësia Elektroprenos me rreth 280 të punësuar, bashkë me rreth 20 të punësuar nga Qendra Dispencere e atëhershme, ndarja e kësaj njësie në vitin 2005 shënoi themelimin e MEPSO-s. Kjo vetvetiu flet se Njësia ORrT , si trashëgimtare direkte e Elektroprenosit, është themeli i krijimit të MEPSO-s si operatori i vetëm i sistemit transmetues të Maqedonisë.

Duke pasur parasysh historinë e pasur mbi 60-vjeçare, me qindra projekte të realizuara – nga ndërtimi i linjave të reja, zgjerimi i nënstacioneve, modernizimi i pajisjeve primare dhe sekondare në disa epoka teknologjike, përballja me situata kritike dhe sanimi i defekteve – e ardhmja e Njesisë ORrT është vetëm të vazhdojë atë që e ka bërë me dekada: të jetë motori dhe forca lëvizëse në zhvillimin e sistemit transmetues, garantues i stabilitetit dhe besueshmërisë, burim i krijimtarisë, inovacionit dhe futjes së teknologjive të reja të përshtatshme për kohën në të cilën jetojmë dhe punojmë.

„ Brezi i ri tashmë është në ngritje – një brez që ka mundësi të bëjë diçka ndryshe në mënyrën e të menduarit dhe funksionimit, të mbizotërojë fryma ekipore dhe respekti reciprok. Të shfrytëzojmë përvojën e të moshuarve dhe të orientohejmë drejt punës që gjithmonë e ka karakterizuar Njësinë ORrT , sepse këtë ua kemi borxh brezave që kanë ecur para nesh.”



Këtë rast e shfrytëzoj të falënderoj të gjithë ata që lanë gjurmë të përhershme në punën e Njesisë ORrT dhe të inkurajoj të rinjtë të mos kenë frikë nga përgjegjësia dhe të investojnë në vetvete. Ajo që unë mund ta premtoj është se qëllimi im do të jetë që thelbësisht dhe strukturalisht ta pozicionoj Njësinë ORrT aty ku gjithmonë i ka takuar të jetë – njësia kryesore organizative në ShA MEPSO.

PROJEKTE

DIXHITALIZIMI I TRAFOSTACIONIT 110 kV KRIVA REKA-NJË HAP PËRPARA DREJT TRANSFORMIMIT DIXHITAL

Pergatiti: m-r Branka Vasiq inxhinierë përgjegjëse për planifikim strategjik



Trafostacion i vogël, po me rëndësi të madhe

Në botën dinamike të energjetikës, modernizimi dhe dixhitalizimi i infrastrukturës elektro-energjetike bëhen domosdoshmëri. MEPSO do të bëjë një hap të rëndësishëm në këtë drejtim me projektin për dixhitalizim dhe rekonstruktiv të trafostacionit Kriva Reka, një nga stacionet më të vjetra, por shumë të rëndësishme në Maqedoninë lindore.

Ky projekt paraqet një kthesë të rëndësishme për MEPSO-n, e cila përmes futjes së teknologjive moderne dixhitale synon të rrisë efikasitetin, besueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.

Trafostacioni i Kriva Rekës është implant me nivele tensioni 110/35/10 kV, i vendosur në pjesën verilindore të vendit, afër Kratovës. I ndërtuar disa dekada më parë, aktualisht është në kompetencë operative të EVN Maqedoni. Edhe pse i vogël në madhësi, roli i tij është jetik – siguron lidhshmëri dhe furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike për rajonin më të gjerë midis Kumanovës, Probishtipit dhe Kriva Palankës.

Të vetëdijshëm për rëndësinë e tij dhe nevojën për rinovim, MEPSO e zgjodhi Kriva Rekën si projekt pilot për futjen e stacionit transformues dixhital – një koncept që integron sistemet mbrojtëse, menaxhuese dhe matëse me teknologji të avancuara komunikimi. Projekti jo vetëm do të mundësojë zëvendësimin e pajisjeve të vjetruara të tensionit të lartë, por do ta shndërrojë stacionin në një implant modern, të menaxhuar dixhitalisht dhe të kontrolluar nga distanca, në përputhje me standardet evropiane për rrjete „smart grid“.



Shtirja e modernizimit

Modernizimi përfshin zëvendësim dhe rekonstruktivitet të plotë të pajisjeve primare elektrike dhe futjen e sistemeve të reja për mbrojtje dhe menaxhim. Elementet ekzistuese të pajisjeve 110 kV do të demontohen dhe zëvendësohen me pajisje moderne që plotësojnë të gjitha standardet teknike dhe të sigurisë.

Për më tepër, do të instalohen dy transformatorë të rinj energjetikë 110/35 kV me fuqi nga 20 MVA secili, me çka do të rritet kapaciteti dhe fleksibiliteti i stacionit. Do të instalohet edhe një transformator ndihmës tensioni 50 kVA, me mbrojtje përkatëse dhe ndarës grumbullues.

Një pjesë e rëndësishme e projektit është edhe futja e sistemit të ri dixhital për mbrojtje dhe menaxhim, i cili do të përfshijë gjashtë dollapë dixhitalë menaxhimi, dollapë mbrojtës dhe integrim në sistemin lokal SCADA për mbikëqyrje dhe menaxhim nga distanca. Kjo do të mundësojë monitorim në kohë reale të gjendjeve, automatizim të proceseve dhe zbulim më të shpejtë të defekteve – përfitime kyçe të stacioneve transformuese dixhitale.

Qëllimi kryesor i projektit nuk është vetëm zëvendësimi i pajisjeve, por transformimi i mënyrës së menaxhimit të stacioneve transformuese në vend. Pas përfundimit të rekonstruktimit, stacioni transformues Kriva Reka do të menaxhohet plotësisht nga MEPSO, nga distanca, pa nevojë për prani të përhershme të operatorëve në vendngjarje. Sipas rekomandimeve të RTE International, do të aplikohen sisteme të dyfishta (redundante) për mbrojtje dhe menaxhim. Sistemi kryesor (A) do të

vendoset në ndërtesën ekzistuese të administratës, ndërsa sistemi rezervë (B)

do të jetë në një kontejner të veçantë, i ndarë nga kryesori. Ky qasje siguron besueshmëri më të lartë dhe vazhdueshmëri të punës, edhe në rast defekti të njërës prej sistemeve.

Një arkitekturë e tillë është standard për stacionet moderne dixhitale – mundëson rezistencë më të madhe ndaj kërcënimeve kibernetike dhe fizike, mirëmbajtje më të lehtë dhe mundësi për zgjerime të ardhshme. Sistemet e reja dixhitale do të përdorin fibra optike në vend të kabllove tradicionale të bakrit, me çka zvogëlohet kompleksiteti dhe rritet saktësia e transmetimit të të dhënave.



Projekt pilot për të ardhmen energjetike të zgjuar të Maqedonisë

Projekti i dixhitalizimit të stacionit transformues Kriva Reka paraqet iniciativë pilot që do të shërbejë si model për modernizime të ardhshme të trafostacioneve në tërë vendin. Duke kombinuar rekonstruktivitetin e pajisjeve primare dhe futjen e teknologjive dixhitale, MEPSO vendos bazën për një sistem transmetimi modern, të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Si stacioni i parë dixhital në vend, Kriva Reka do të jetë simbol i tranzicionit drejt menaxhimit modern, të qëndrueshëm dhe të sigurt të infrastrukturës energjetike. Pas përfundimit të tij, do të përmirësohet besueshmëria e furnizimit, menaxhimi i rrjetit dhe integrimi i burimeve të rinovueshme. Me planifikim të kujdesshëm, inxhinieri inovative dhe bashkëpunim ndërkombëtar, Kriva Reka do të bëhet shembull pionier i transformimit dixhital në energjetikë – urë midis traditës dhe teknologjisë së së ardhmes.

PROJEKTE

RIKONSTRUKSIONI I LARGPËRÇUESIT 110 Kv

TS SHTIP – TS KOÇAN

Largpërçuesi 110 kV TS Shtip – TS Koçan paraqet një nga objektet energjetike më të rëndësishme në pjesën lindore të shtetit, e cila siguron furnizim të sigurt dhe të besueshëm me energji elektrike për qytetet Koçan, Maqedonska Kamenicë, Berovë, Dellçevë dhe rajonin më të gjerë. Kjo linjë transmetimi është ndërtuar në vitin e largët 1968 dhe për më shumë se pesë dekada paraqet pjesë bazë të rrjetit të transmetimit të transmetimit MEPSO.

Me gjatësi të përgjithshme prej 27,8 kilometrash, linja e transmetimit është ndërtuar me 96 shtylla grillë - çeliku dhe me përcjellës të tipit ACSR 150/25 mm². Pavarësisht se gjatë viteve linja e transmetimit mirëmbahet rregullisht, mosha e konstruksionit dhe ndikimi i kushteve atmosferike imponojnë nevojën për rindërtim të plotë, me qëllim zgjatjen e jetës së shërbimit dhe sigurimin e furnizimit më efikas dhe të besueshëm me energji elektrike.

Me qëllim rritjen e besueshmërisë, stabilitetit dhe sigurisë së rrjetit elektrotransmetues në rajonin lindor, në kuadër të programit investues të MEPSO-s është planifikuar rikonstruksion i plotë i kësaj linje transmetimi gjatë viteve 2026 dhe 2027. Rikonstruksioni do të përfshijë zëvendësimin e një pjese të shtyllave ekzistuese, ndryshimin e telit ACSR me lloj të ri përcjellësi si AAAC ose përcjellës HTLS me bërthamë karboni, të cilët mundësojnë pothuajse dyfishim të kapacitetit të transmetimit të linjës së transmetimit.

Me zbatimin e këtij projekti do të mundësohet ulje e ndjeshme e rrezikut nga ndërprerjet në furnizim,

do të rritet siguria e sistemit dhe do të përmirësohet cilësia e energjisë elektrike që u dorëzohet konsumatorëve. Përveç kësaj, rikonstruksioni do të kontribuojë edhe në uljen e humbjeve teknike, çka paraqet hap të rëndësishëm drejt menaxhimit më efikas dhe të qëndrueshëm të rrjetit elektrotransmetues.



Ky investim paraqet pjesë të strategjisë më të gjerë për modernizim dhe dixhitalizim të rrjetit të transmetimit të MEPSO-s, në drejtim të krijimit të një sistemi më të sigurt dhe energjetikisht më efikas që do t'i plotësojë nevojat për integrim të burimeve të reja të ripërtëritshme të energjisë elektrike.

Me rikonstruimin e largpërçuesit 110 kV Shtip – Koçan, do të sigurohet furnizim afatgjatë dhe stabil me energji elektrike për tërë rajonin lindor, me çka do të krijohen parakushte për zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe industrial të këtij pjese të shtetit.

PROJEKTE

BASHKËPUNIM I SUKSESSHËM ME CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NË RRJETIN E TRANSMETIMIT

Pergatiti: Elena Aqkoska, OST



Një nga masat për uljen e vlerës së tensionit në orët e natës, të cilën MEPSO e ndërmoi në periudhën e kaluar, ishte bashkëpunim intensiv me centralet e mëdha fotovoltaike të lidhura në rrjetin e transmetimit për testimin e mundësisë së absorbimit të fuqisë reaktive nga rrjeti i transmetimit. Qëllimi ishte të ndryshohet regjimi i punës së natës së inverterëve, përkatësisht të aktivizohet Q Night Mode, me qëllim që të shihet efekti në ndryshimin e vlerës së tensionit në pikën e lidhjes së rrjetit të transmetimit.

Rregullimi i tensionit dhe fuqisë reaktive është një nga detyrat e shumta që MEPSO duhet t'i mundësojë gjatë gjendjes normale dhe synon që tensioni në pikën e lidhjes së sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të mbetet stabil brenda diapazonit:

- Niveli i tensionit 400 kV: midis 360 kV dhe 420 kV
- Niveli i tensionit 110 kV: midis 99 kV dhe 123 kV

CF Oslomej 3A dhe 3B

OCF Oslomej 3A (OSM SOLAR ShPKNJ P SHKUP) dhe Oslomej 3B (Fortis Energetika dhe ndertimtari ShPKNJ P Shkup), secilla ka fuqi te instaluar prej 50 MW. Te dy centralet jane te lidhura me lidhje kablllore 110 kV ne gjatesi prej 3 km ne TS Oslomej. Para testimit ne oret e nates, kur centrali nuk prodhon energji, regjistrohej hyrje e fuqise reaktive nga vendi i lidhjes (figura 1 dhe figura 2). Me ngjyre jeshile eshte shenuar fuqia reaktive qe l dorezohet rrjetit te transmetimit.




Figura 1.
Profili i fuqisë reaktive para testimit, CF Oslomej 3A





Figura 2.
Profili i fuqisë reaktive para testimit, CF Oslomej 3B



C Figura 3.
Profil i fuqisë reaktive pas aktivizimit të Q
Night Mode, CF Oslomej 3A




Figura 4.
Profil i fuqisë reaktive pas aktivizimit të Q
Night Mode, CF Oslomej 3B

Në orët e natës inverterët nuk kanë qenë aktivë, ndërsa lidhjet kablore, duke qenë bosh ose të mbingarkuara, gjenerojnë fuqi reaktive. Me aktivizimin e Q Night Mode, inverterët janë aktivë gjatë natës dhe absorbojnë fuqi reaktive (figura 3 dhe figura 4, ku shufrat e kuqe shënojnë energjinë reaktive të marrë nga rrjeti). Në këtë mënyrë, tensioni stabilizohet dhe ulen variacionet e tij, gjë

që është veçanërisht e rëndësishme për stabilitetin e sistemit. Në fig. 5 është paraqitur dallimi në profilin ditor të tensionit në TS Oslomej para dhe pas testimit (6.9.2025 dhe 8.10.2025) dhe mund të konkludohet se regjimi i ri i punës ka ndikim pozitiv në profilin e tensionit, ku është vërejtur ulje e tensionit për rreth 3 kV në orët e natës.




Figura 5.
Profil ditor i tensionit në TS Oslomej
(6.9.2025 dhe 8.10.2025).

CF Novaci

CF Novac (MEJ GRUP ShPK Shkup) ka fuqi të instaluar prej 50 MW dhe është e lidhur me lidhje kablore në gjatësi prej 3,5 km në trafostacionin 110 kV Manastir 2. Në TS Manastir 2 në 110 kV është i lidhur edhe

Blloku 1 (225 MW) nga TEC Manastir. Në orët e natës, nga vendi i lidhjes së CF Novaci drejt rrjetit të transmetimit matet hyrje e fuqisë reaktive prej rreth 4 MVar (figura 6).




Figura 6.
Profili i fuqisë reaktive para
testimit, CF Novaci




Figura 7
. Profili i fuqisë reaktive pas
testimit, CF Novaci

Pas aktivizimit të Q Night Mode, inverterët jo vetëm që e neutralizuan fuqinë reaktive të prodhuar nga kabli i lidhjes, por edhe absorbojnë aktivisht energji reaktive nga rrjeti

(figura 7). Për ilustrim të kësaj ndryshimi në vlerën e tensionit është zgjedhur një ditë kur Blloku 1 nuk është në punë, sepse atëherë efektet janë të dukshme (figura 8).




Figura 8.
Profili ditor i tensionit në TS Manastir 2
(6.9.2025 dhe 10.10.2025), Blloku 1 jashtë
pune

Më 10 tetor, kur Blloku 1 është i çkyçur dhe inverterët në CF Novaci janë të kyçur në regjimin e ri të punës, vërehet se në orët e

natës vjen deri te ulja e tensionit, çka e konfirmon efektin pozitiv të mënyrës së re të menaxhimit të tyre.

Konkluzion

Rezultatet e testimeve tregojnë se aktivizimi i Q Night Mode kontribuon ndjeshëm në stabilizimin e tensionit në rrjetin e transmetimit. Me këtë, centralet fotovoltaike mund të marrin pjesë aktivisht në menaxhimin e tensionit dhe në mbajtjen e stabilitetit të sistemit. Këto rezultate e konfirmojnë drejtimin drejt integritetit të burimeve të ripërtëritshme, ku centralet diellore nuk janë vetëm prodhues, por edhe pjesëmarrës aktivë në rregullimin e rrjetit..

PROJEKTE

DEBATË PUBLIKE PËR GRID MASTER PLAN PËR RRJETIN E TRASMETIMIT

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe përfshirjes aktive të palëve të interesuara, MEPSO e filloi debatin publik për Studimin për planifikim dhe zhvillim të infrastrukturës inteligjente të rrjetit elektrotransmetues – Master Plan për rrjetin.



Ky dokument paraqet bazën strategjike për zhvillimin afatgjatë, modernizimin dhe dixhitalizimin e sistemit elektrotransmetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me të definojnë drejtimet e mundshme të zhvillimit dhe investimet e nevojshme për furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji elektrike në dekadat e ardhshme.

Qëllimi i debatit publik

Debati publik ka për qëllim të sigurojë një proces të hapur dhe transparent konsultimesh në të cilin institucionet, pjesëmarrësit në treg, investorët dhe publiku i gjerë mund të shqyrtojnë dhe komentojnë të dhënat planifikuese dhe skenarët që janë bazë e studimit. Kjo qasje është në përputhje me Rregullat e rrjetit për transmetimin e energjisë elektrike, neni 17, sipas të cilave MEPSO i harmonizon planet e tij zhvillimore me përdoruesit e sistemit dhe palët e tjera të interesuara.

Përmbledhje e skenarëve zhvillimorë

Në kuadër të Master planit shqyrtohen disa skenarë të mundshëm për zhvillimin e rrjetit transmetues, me qëllim që të sigurohet siguria, fleksibiliteti dhe gatishmëria e tij për tranzicionin energjetik:

1. Skenari referencë

Paraqet vazhdimin e trendeve dhe politikave aktuale dhe shërben si bazë për krahasim me opsionet më ambicioze

2. Skenari i modernizimit të moderuar
Parashikon forcim gradual dhe dixhitalizim të rrjetit me qëllim integrimin e një pjese të moderuar të burimeve të ripërtëritshme, përmirësimin e efikasitetit dhe rritjen e lidhshmërisë rajonale.

3. Skenari i avancuar – Rrjet inteligjent

I referohet modernizimit të përsheptuar të infrastrukturës, integritit intensiv të burimeve të ripërtëritshme, futjes së sistemeve për ruajtjen e energjisë dhe aplikimit të mjeteve të avancuara dixhitale për menaxhimin e rrjetit në kohë reale.

MEPSO e sheh këtë debat publik jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe si mundësi për dialog të hapur për të ardhmen e sistemit energjetik. Pas përfundimit të debatit publik, MEPSO bashkë me ekipin konsultues do t'i analizojë të gjitha komentet e pranuar dhe do ta përgatisë versionin final të Master Planit.

Me këtë proces, MEPSO edhe një herë e konfirmon përkushtimin e tij ndaj planifikimit transparent, bashkëpunimit rajonal dhe një të ardhmeje energjetike të qëndrueshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PROJEKTE

REAKTORI I RI SHANT NË TS DUBROVË PËR NJË SISTEM ELEKTROENERGJETIK MË STABIL DHE MË EFIKAS

Në kuadër të aktiviteteve për modernizim dhe avancim të stabilitetit dhe sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, në TS Dubrovë është në realizim e sipër një projekt i rëndësishëm: instalimi i një reaktori të ri shant, pajisje me rol kyç në kontrollin dhe mbajtjen e nivelit optimal të tensionit në sistemin elektroenergjetik gjatë gjithë ditës.



Çfarë është reaktori shant dhe pse është i nevojshëm?

Reaktori shant është komponent kritik i rrjetit elektrik. Është pajisje që lidhet paralel me linjat e transmetimit dhe ka për detyrë të absorbojë tepriçen e fuqisë reaktive. Me këtë, ai stabilizon gjendjen e tensionit dhe parandalon shfaqjen e mbingtensionit që mund të dëmtojë izolimet e transformatorëve, kabllave, pajisjeve VN, etj., veçanërisht në situata me ngarkesa të ulëta dhe linja të gjata transmetimi. Edhe pse rrallë përmenden në publik, reaktorët shant konsiderohen heronj të heshtur në energjetikë sepse sigurojnë funksionim të pandërprerë të sistemit, tension stabil, humbje më të vogla dhe furnizim të sigurt me energji elektrike.

Nevoja për prokurim dhe instalim të reaktorit shant në këtë stacion transformatori është rezultat i faktit se sistemi i transmetimit me vite përballet me oscilacione të tensionit që mund të shkaktojnë mbingtensione ose furnizim të pabarabartë. Për këtë qëllim, do të zgjerohet impianti 400 kV në TS Dubrovë

me një fushë të re të parashikuar ku do të vendoset reaktori shant prej 150 MVar. Në koordinim me operatorët e sistemeve të transmetimit të vendeve fqinje, ky projekt do të mundësojë zbutjen e pasojave nga situatat me tensione të larta, uljen e rrezikut nga ndërprerjet, stabilitet dhe efikasitet më të madh të sistemit të transmetimit, si dhe furnizim të sigurt me energji elektrike drejt konsumatorëve.

Përfitime për rrjetin e transmetimit dhe qytetarët

Instalimi i reaktorit shant do të sjellë përfitime të shumëfishta.

Për rrjetin: ulje të humbjeve të energjisë, rritje të efikasitetit dhe jetëgjatësi më të madhe të impianteve, si dhe siguri më e lartë. Reaktori do të mundësojë gjithashtu integrim më të lehtë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (erë dhe diell), të cilat kërkojnë kontroll preciz të tensionit.

Për konsumatorët: furnizim më cilësor dhe më i sigurt, shpenzime potencialisht më të ulëta dhe mbrojtje më e madhe e pajisjeve elektrike shtëpiake dhe industriale.

Këto aktivitete janë pjesë e strategjisë më të gjerë të kompanisë për modernizim dhe dixhitalizim të infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike, e cila, përveç instalimit të reaktorit shant, përfshin edhe modernizimin e sistemit SCADA, si dhe integrimin e platformave evropiane për balancim (PICASSO dhe MARI). Me këtë, sistemi i transmetimit përgatitet për të ardhmen ku burimet e ripërtëritshme do të dominojnë, ndërsa fleksibiliteti dhe dixhitalizimi do të jenë faktorë kyç për furnizim të sigurt dhe stabil.

Projekti për prokurimin e reaktorit shant ka nisur në mesin e vitit 2024, ndërsa vënia në punë e tij është planifikuar për fillim të vitit 2027.

TRAFOSTACIONI SH TIP – NYJE ENERGJETIKE ME RËNDËSI STRATEGJIKE

Pergatiti: Irina Daskallovska Qosevska



Trafostacioni Shtip paraqet një nga nyjet energjetike më të rëndësishme të rrjetit elektrotransmetues të Maqedonisë së Veriut dhe një krenari reale e MEPSO-s. Me pozicionin e saj gjeostrategjik dhe përsosmërinë teknologjike, ajo siguron furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike në pjesën lindore dhe juglindore të vendit, duke lidhur sistemin tonë nacional me sistemet energjetike të Serbisë dhe Bullgarisë.

dhe në lindje me TS Cërvena Mogila, R. Bullgari. Për më tepër, përmes linjës 400 kV është e lidhur me TS Dubrovë, çka mundëson rrjedhje të sigurt dhe të qëndrueshme të energjisë përmes sistemit nacional

Zyrtarisht është vënë në përdorim në vitin 2010, si një përmirësim modern i TS ekzistues Shtip 1, e cila funksionon që nga viti 1959. Me këtë vazhdon tradita disadekadëshe e Shtipit si qendër energjetike në rajonin lindor.

Lidhja me rajonin dhe zhvillimi historik

TC TS Shtip paraqet një urë energjetike kyçe midis vendeve të rajonit. Ajo është e lidhur përmes dy linjave interkonektive: në veri me TS Vranjë 4, R. Serbi

Trafostacioni i parë me mbrojtje plotësisht mikroprocesorike

TS Shtip është stacioni i parë transformues në vend në të cilin është integruar plotësisht sistemi për mbrojtje dhe menaxhim mikroprocesorik, me komunikim përmes fibrave optike.

Ky përparim teknologjik mundëson komunikim më të shpejtë dhe më efikas midis pajisjeve, monitorim të vazhdueshëm të gjendjeve në sistem dhe reagim në kohë në çdo ndryshim, defekt ose rrezik. Me këtë, ndjeshëm zvogëlohet mundësia e gabimit njerëzor, ndërsa sistemi bëhet më i qëndrueshëm dhe më i sigurt.

„Ky trafostacion është shembull se si teknologjia dhe faktori njerëzor bashkë krijojnë një sistem të qëndrueshëm. Çdo komponent është vendosur me idenë e besueshmërisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë,” thotë Pavle Velinov, udhëheqës i TS Shtip



Qendër ndihmëse dispeçere – zemra rezervë e sistemit nacional

Rëndësia e TS Shtip është përforcuar edhe më tej me faktin se në përbërjen e saj funksionon edhe Qendra Ndihmëse Dispeçere (DC) e ShA MEPSO. Kjo qendër ka rol kyç në rast të fatkeqësive natyrore, rreziqeve të sigurisë ose ndërprerjes së punës së Qendrës Nacionale Dispeçere në Shkup.

Në rrethana të tilla, DC i Shtipit mund plotësisht të marrë përsipër funksionin e saj.

Në ndërtesën komanduese të trafostacionit gjenden edhe serverët crash, në të cilët ruhen të gjitha të dhënat aktuale dhe arkivore për punën e sistemit të ShA MEPSO. Kjo infrastrukturë digjitale e bën TS Shtip jo vetëm operacional, por edhe qendër strategjike të sigurisë me rëndësi nacionale.

Qendër rajonale me shtrirje të gjerë operative

TS Shtip është selia e Qendrës Rajonale Shtip, në përbërjen e së cilës përfshihen nëntë stacione transformuese:

TS Shtip 2, TS Ovçe Pole, TS Bogoslovec, TS Koçani, TS Maqedonska Kamenicë, TS Dellçevë, TS Berovë, TS Neokazi dhe TS Kriva Palankë, nga të cilat dy janë me personel të EVN.

Kjo shtrirje e gjerë operative do të thotë se ekipi i TS Shtip çdo ditë koordinon aktivitete në një territor të madh, duke siguruar besueshmëri dhe qëndrueshmëri të tërë sistemit lindor të transmetimit të energjisë elektrike.



Ekipi – forcë lëvizëse e qëndrueshmërisë

Udhëheqësi Pavle Velinov, inxhinier elektrik i diplomuar me 32 vjet përvojë në ShA MEPSO, së bashku me 18 punonjës me përvojë dhe të trajnuar lart, kujdesen për funksionim të pandërprerë të sistemit.

„Puna në një objekt kaq strategjik kërkon përqendrim dhe përkushtim maksimal. Nuk ka orar fiks pune kur shfaqet problem ose ngjarje urgjente, reagojmë menjëherë, pavarësisht orës. E gjitha kjo do të ishte e pamundur pa kolegialitet, besim dhe bashkëpunim të mirë midis njerëzve,” thotë Velinov.



Ekipi përfshin montues, elektrikë, teknikë, operatorë dhe shërbyes mirëmbajtjeje, të cilët punojnë në mënyrë të sinkronizuar, duke siguruar operativitet 24-orësh. Në kuadër të trafostacionit funksionojnë edhe ekipi i linjave të largëta, shërbimi i sigurisë dhe shërbimi komandues.



Siguria dhe trajnimi i vazhdueshëm – garanci për sistem të qëndrueshëm

Në TS Shtip, siguria dhe dituria paraqesin themelin e çdo aktiviteti. Çdo punonjës rregullisht ndjek trajnime për punë me tension të lartë, mbrojtje kundër zjarrit dhe menaxhim në situata krizash. Periodikisht kryhen testime të pajisjeve, revizion i mbrojtjeve dhe simulime defektesh, me qëllim verifikimin e gatishmërisë së sistemit.

„Trajnimet e vazhdueshme na ndihmojnë të jemi një hap para rrezikut të mundshëm. Kur punon me tension dhe teknologji të tillë, nuk ka vend për improvizim, por vetëm dituri dhe saktësi,” thekson Velinov.

Pajisjet në stacion janë të gjeneratës më të fundit të pajisjeve të tensionit të lartë, ndërsa sistemet e monitorimit mundësojnë menaxhim nga distanca dhe ndërhyrje në kohë. Në objekt është implementuar sistem i automatizuar kundër zjarrit me centralë inteligjente, rrjet hidrantësh dhe aparate kundër zjarrit të përshtatura për lloje të ndryshme të rreziqeve.



GRATË NË ENERGJETIKË

VENDI IM ËSHTË KËTU-NË ENERGJETIKË, MIDIS SFIDAVE DHE ZGJIDHJEVE

Interviste me Magdalena Sekulovska-elektroinxhinierë



Në botën dinamike të energjetikës, ku takohen sisteme teknologjike inovative dhe komplekse, individë si Magdalena Sekulovska luajnë rol kyç në formësimin e sektorit. Magdalena punon në Departamentin për revitelizim në njësine e ORT-së. Është inxhinierë e diplomuar dhe tashmë 13 vjet ndërton karrierë të suksesshme në energjetikë

Magdalena, çfarë ju tërhoqi drejt inxhinierisë elektrike? A ishte zgjedhja e

duhur dhe cila është rruga juaj e karrierës?

Para regjistrimit në studimet master, kurrë nuk e imagjinoja veten si inxhinierë elektrike. Megjithatë, pikërisht gjatë studimeve lindi interesi im për energjetikën dhe dëshira për të vazhduar më tej në këtë fushë. Takimi i parë me elektroenergjetikën dhe menaxhimin e objekteve elektroenergjetike e përjetova si pikë kthese, ajo thjesht hyri në jetën time dhe që atëherë ndjeva se jam në rrugën e duhur.

Karrierën time e fillova në departamentin për revitelizim, dhe sot, pas më shumë se një dekade

përvojë pune në ShA MEPSO, kam përgjegjësinë të jem Udhëheqëse e shërbimit elektrik. Që nga dita e parë u përballa me sfida të shumta, por edhe fitova njohuri dhe përvoja të reja dhe pikërisht përmes asaj përpjekjeje, këmbënguljeje dhe përkushtimi, e kalova rrugën deri në pozicionin aktual. Me siguri mund të them se zgjedhja për të qenë elektroinxhinieri ishte e duhura.



Shpesh thuhet se energjetika është profesion “meshkujsh”. Nëse është kështu, si mund ta rrisin gratë kontributin e tyre në tranzicionin energjetik?

Është e vërtetë se shpesh energjetika perceptohet si profesion mashkullor, por kjo nuk do të thotë se vërtet është kështu, sidomos jo sot kur gjërat ndryshojnë me shpejtësi dhe rolet gjinore balancohen. Besoj se gratë sjellin perspektivë të ndryshme dhe kanë qasje tjetër ndaj punës, sidomos kur bëhet fjalë për organizim, punë ekipore dhe bashkëpunim gjatë kryerjes së detyrave. Këto janë cilësi jashtëzakonisht të rëndësishme në sektorin energjetik, sidomos në procesin e tranzicionit energjetik.

Për të rritur kontributin e tyre, më e rëndësishmja është që gratë të besojnë në vetvete, të investojnë në edukim, të jenë të përkushtuara dhe profesionale. Mbështetja nga kolegët sigurisht luan rol të rëndësishëm, por suksesi vjen nga vetëbesimi dhe këmbëngulja.

Cilat sfida profesionale ju ndihmuan të përparoni? A mund të ndani shembull nga ndonjë projekt kompleks?

Po, pajtohem se më së shumti mësohet nga sfidat profesionale. Për mua, një nga më të rëndësishmet ishte projekti për Rehabilitim në TS Shkup 4. Bëhej fjalë për zëvendësim të plotë të pajisjeve primare dhe sekondare, pra për projekt shumë kompleks që kërkonte koordinim të kujdesshëm me disa ekipe dhe planifikim preciz të të gjitha aktiviteteve për të mos dëmtuar qëndrueshmërinë e sistemit elektro-energjetik.

Gjatë realizimit, isha aktivisht e përfshirë në të gjitha fazat dhe me mbështetje nga ekipet profesionale, fitova kuptim të përgjithshëm se si planifikohet një projekt i tillë, si organizohet puna dhe si zbatohet me sukses.

Ky projekt jo vetëm më ndihmoi të përparoj profesionalisht, por më tregoi sa e rëndësishme është puna ekipore, përgjegjësia dhe aftësia për të marrë vendime të shpejta nën presion.



E theksoni punën ekipore si faktor kyç për detyrë të suksesshme, por cilat janë detyrat tuaja konkrete?

Si elektroinxhinieri me përvojë shumëvjeçare, mbaj përgjegjësi për një sërë detyrash teknike dhe projektuese që kërkojnë nivel të lartë profesionalizmi, detajshmërie dhe qasjeje përgjegjëse.

Puna ime përfshin përgatitje dhe analizë të dokumentacionit teknik, përgatitje të projekteve për lidhje sekondare gjatë zëvendësimit të ndërprerësve dhe ndarësve, si dhe përgatitje të dokumentacionit tenderues sipas specifikimeve teknike dhe rregulloreve.

Gjithashtu, marr pjesë aktivisht në mbikëqyrje dhe koordinim të aktiviteteve gjatë ndryshimit të pajisjeve primare dhe sekondare, sidomos kur punën e kryejnë firma të jashtme-zbatuese.

Është e rëndësishme të sigurohet respektim konsekuent i standardeve teknike dhe të ruhet qëndrueshmëria e sistemit.

Si grua inxhinierë në energjetikë, investoj përpjekje të veçantë për të treguar se profesionalizmi, profesionaliteti dhe rezultatet nuk njohin dallime gjinore, por janë rezultat i njohurive, përkushtimit, punëtorisë dhe ndarjes pa egoizëm të përvojës.



Çfarë mesazhi do t'u dërgonit të rinjve që mendojnë për inxhinieri?

Të gjithë të rinjve që ndoshta mendojnë për inxhinieri dhe akoma më shumë për energjetikë, do t'u këshilloja të mos kenë frikë nga sfidat. Nëse jeni kuriozë, interesoheni për shkencat teknike dhe keni dëshirë të zgjidhni probleme reale, mos hezitoni. Ndiqni profesionin që ju inspiron.

Inxhinieria nuk është as "mashkullore" as "femërore", është profesion për njerëz të guximshëm, të vendosur dhe të përkushtuar që duan të lënë gjurmë. Është rruga që kërkon shumë punë, por sjell qëndrueshmëri, dinamikë dhe më e rëndësishmja, mundësi për të krijuar zgjidhje të zbatueshme që ndryshojnë botën.

„Mos prisni dikush t'ju thërrasë dhe t'ju thotë se mundeni. Besoni në vetvete dhe filloni. Inxhinieria është për ata që nuk duan vetëm të flasin për të ardhmen, por ta ndërtojnë.”

SIGURIA NUK ËSHTË RASTËSI

Pergatiti: Irina Dasakallovsk Qosevska

Në çdo pjesë të sistemit elektroenergjetik ekzistojnë njerëz, detyrat e të cilëve rrallë vërehen, por puna e tyre është kyçe për stabilitetin dhe sigurinë e tërë rrjetit. Ata nuk janë nën dritat e reflektorëve, por puna e tyre ndihet në momentet kur rryma rrjedh pa pengesë deri në çdo shtëpi dhe objekt industrial. E tillë është edhe roli i ekipit të Departamentit për mbrojtje rele dhe lidhje sekondare pranë SHA MEP SO, i udhëhequr nga Stefçe Stefanovski, inxhinier me 20 vjet përvojë dhe përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj saktësisë dhe sigurisë së sistemit.




„Puna jonë nuk shihet çdo ditë, por ndihet çdo sekondë. Kur sistemi është stabil, kjo do të thotë se mbrojtja e ka kryer detyrën e saj,” thotë Stefçe Stefanovski, udhëheqës i Departamentit për mbrojtje rele dhe lidhje sekondare

Dita e punës së ekipit fillon herët, me kontrollin e alarmeve, raporteve dhe gjendjes së pajisjeve mbrojtëse në sistem. Çdo situatë nga dita e kaluar analizohet me kujdes: a janë aktivizuar relet, a është regjistruar ndonjë anomali dhe a funksionon sistemi pa pengesa. Pastaj vjen planifikimi i aktiviteteve ditore si testime të rregullta, kontrolle në terren, llogaritje dhe përgatitje të dokumentacionit teknik.

„Çdo mëngjes fillojmë me analizën e sistemit. Nëse ndonjë pajisje ka reaguar, duhet të dimë saktësisht pse. Ky është hapi i parë në parandalimin e defekteve më të mëdha,” shpjegon Stefanovski.

Departamenti që ai udhëheq përbëhet nga shërbimi për testim, shërbimi për mirëmbajtje dhe shërbimi për analizë me llogaritje të mbrojtjes rele. Misioni i tyre i përbashkët është i thjeshtë sipas përkufizimit, por jashtëzakonisht kompleks në ekzekutim: të sigurojnë stabilitetin dhe sigurinë e tërë sistemit të transmetimit elektroenergjetik.

Kjo nënkupton testime të rregullta të pajisjeve, konfigurim dhe aktivizim të pajisjeve të reja të instaluar, analizë të defekteve, matje dhe përgatitje të raporteve teknike.



Mbrojtja rele, shpjegon Stefanovski, është „rojtari i padukshëm” i sistemit, i përbërë nga pajisje dhe algoritme që vazhdimisht ndjekin gjendjen e rrjetit dhe automatikisht izolojnë seksionin e dëmtuar në rast defekti..

„Ajo është vija e fundit e mbrojtjes. Pa të do të kishim avari, pajisje të dëmtuara dhe ndërprerje serioze të furnizimit me energji elektrike,” thotë ai.



Stefçe Stefanovski, udheheqës

Inxhinierët çdo ditë punojnë me pajisje më të avancuara si rele dixhitale nga prodhuesit kryesorë Siemens, ABB, GE dhe SEL; instrumente për testim OMICRON, Megger dhe SVERKER, si dhe me softuer të specializuar CAPE për analizë dhe llogaritje.

„Dixhitalizimi”, thekson Stefanovski, e ndryshoi ndjeshëm profesionin tonë. Sot gjithçka është e lidhur përmes sistemeve komunikuese. Mund të qasemi nga distanca në një pajisje, të analizojmë sjelljen e saj, madje të bëjmë edhe rregullim të imët pa qenë fizikisht të pranishëm.”



Goran Dimitrievski, teknik

Ekipi numëron gjashtë inxhinierë dhe dy teknikë, të organizuar në tre ekipe terreni dhe dy inxhinierë që

fokusohen në analizë dhe projektim. Në raste të ndërhyrjeve më komplekse, puna është ekipore dhe rreptësisht e koordinuar.

„Çdo defekt është një histori e ndryshme. Ndonjëherë punohet nën presion dhe në kushte të paparashikueshme, por njohuritë dhe besimi mes kolegëve janë forca jonë më e madhe,” thotë Stefanovski

Një nga rastet më komplekse në punën e mbrojtësve ka qenë defekti në transformator 400/110 kV, dhe shkaku i aktivizimit të mbrojtjes është zbuluar përmes analizës së detajuar të oscilogramëve.

„Këto momente kërkojnë saktësi teknike dhe durim, por pikërisht ato sjellin kënaqësinë më të madhe profesionale,” shpjegon Stefanovski.

Siguria është prioritet absolut. Çdo hap në terren kryhet me shkëputje të plotë të furnizimit, me pajisje mbrojtëse dhe kontroll të dyfishtë të çdo procedure.



Aleksandar Atanasovski, teknik

„Punohet me tensione të larta dhe këtu nuk ka vend për improvizim. Respektimi i procedurave është i vetmi mënyrë që të gjithë të mbetemi të sigurt,” shton ai.

Motivi për këtë profesion, sipas tij, qëndron në ndjenjën e përgjegjësisë dhe vetëdijes se puna e përditshme kontribuon në stabilitetin e tërë sistemit. *„Kënaqësia jonë më e madhe është kur rrjeti punon në mënyrë perfekte dhe nuk ka defekte. Kjo do të thotë se kemi bërë gjithçka siç duhet. Ndjenja se e ruajmë sigurinë e tërë shtetit është e paçmueshme,” përfundon Stefanovski.*

KONFERENCA, DEBATE, FORUME

MEPSO NË ADRIA FORUM 2025

Përfaqësuesit e MEPSO-s, Ivan Ivanov dhe Enis Drndar, ishin pjesë e Adria Forum 2025, një ngjarje prestigjioze rajonale nën moton „Empowering the Digital Future”, kushtuar transformimit digjital, teknologjive të bazuara në cloud dhe sigurisë kibernetike.

Ngjarja mbledhi në një vend ekspertë dhe kompani nga sektori i TIK-ut që zbatojnë zgjidhje inovative dhe integritime IT në industri të ndryshme, përfshirë edhe energjetikën. Forumi mundësoi shkëmbimin e përvojave, ideve dhe praktikave të mira në fushën e menaxhimit të infrastrukturave moderne IT dhe sistemeve të sigurisë.

Pjesëmarrja e MEPSO-s mundësoi njohjen me drejtimet më të reja teknologjike dhe krijimin e



kontakteve të reja me kompani dhe partnerë që ofrojnë zgjidhje moderne IT të zbatueshme në sektorin energjetik.

MAKO SIGRE 2025

Panel diskutimi „Sfida të sistemeve energjetikemoderne” ishte një nga sesionet kyçe në kuadër të konferencës së këtij viti - MAKO SIGRE

Në një atmosferë profesionale dhe konstruktive u shqyrtuan sfidat aktuale para të cilave gjenden operatorët e sistemeve elektroenergjetike, ku vëmendje e veçantë iu kushtua procesit të tranzicionit energjetik, integritimit të burimeve të ripërtëritshme, si dhe nevojës së rritur për fleksibilitet dhe siguri të sistemit.

Ke Këtë vit në konferencë morën pjesë më shumë se 40 punonjës të ShA MEPSO, të cilët prezantuan 20 punime shkencore dhe profesionale.



DEKLARATA E SHKUPIT- UDHËRRËFYES I RI DREJT NJË TË ARDHMEJE TË QËNDRUESHME DHE TË DREJTË ENERGETIKE

Në një kohë kur bota përballet me sfida serioze klimatike, ekonomike dhe energjetike, **"Deklarata e Shkupit"** dërgon një mesazh të fortë rajonal dhe global se tranzicioni drejt energjisë së pastër, të sigurt dhe të drejtë është një mundësi, jo pengesë për zhvillim.

Dokumenti u nënshkrua në kuadër të Forumit të 14-të Ndërkombëtar për energji dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke e pozicionuar Shkupin si simbol të një faze të re në bashkëpunimin energjetik rajonal dhe si pikënisje për një impuls të ri të solidaritetit, vizionit dhe inovacionit

Një udhërrëfyes konkret, jo vetëm një deklaratë politike

"Deklarata e Shkupit" paraqet një udhëzues praktik se si vendet e rajonit dhe më gjerë mund të përshpejtojnë bashkërisht tranzicionin e gjelbër. Deklarata lidh nevojën për siguri energjetike me vizionin për zhvillim të qëndrueshëm, duke treguar se modernizimi i sistemeve energjetike mund të sjellë njëkohësisht rritje ekonomike, përparim teknologjik dhe barazi sociale.


Në thelb, dokumenti është një thirrje për veprim të përbashkët, duke theksuar prioritetet sin ë vijim:

- **Planifikimi energjetik dhe integrimi sistemor**
- **Digjitalizimi dhe inovacioni**
- **Tranzicion i drejtë dhe gjithëpërfshirës**
- **Zgjidhje të bazuara në natyrë**

Me këto udhëzime, deklarata lidh objektivat globale si Agjenda 2030, Objektivi 7 për energji të pastër dhe moderne, dhe Marrëveshja e Parisit, me hapa konkretë rajonalë që synojnë të sjellin rezultate të dukshme.

Siguria energjetike dhe bashkëpunimi rajonal

Deklarata vendos sigurinë energjetike në qendër të politikave kombëtare dhe rajonale. Vendet ftohen të diversifikojnë burimet e energjisë, të zhvillojnë prodhimin lokal të teknologjive të pastra dhe të ndërtojnë zinxhirë furnizimi të qëndrueshëm. Për këtë arsye, dokumenti nxit



lidhje dhe bashkëpunim më të madh ndërkombëtar dhe rajonal për të siguruar furnizim me energji me emetime të ulëta karboni.

Zhvillimet e reja në sektorin energjetik

Përparimi i shpejtë në digjitalizim, inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e zgjuara duhet të shfrytëzohet për të rritur efikasitetin energjetik dhe për të krijuar vende të reja pune të gjelbra. Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të energjisë diellore, të erës, hidroenergjisë, gjeotermale dhe energjisë me hidrogjen, si dhe zgjidhjeve për ruajtjen e energjisë që do të sigurojnë sisteme fleksibël dhe të qëndrueshme.

Tranzicion i drejtë dhe barazi sociale

Д Декларata thekson se tranzicioni i drejtë duhet të përfshijë të gjithë. Propozohen masa për mbrojtjen e amvisërive me të ardhura të ulëta, reforma të subvencioneve dhe përmirësimi i qasjes në karburante të pastra dhe zgjidhje të decentralizuara, veçanërisht në zonat rurale. Sipas dokumentit, tranzicioni energjetik nuk është vetëm një proces teknologjik, por një transformim shoqëror.

Planifikimi dhe integrimi energjetik

Efikasiteti energjetik duhet të trajtohet si karburanti kryesor. Strategjitë kombëtare dhe rajonale duhet të mundësojnë integrimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në planifikimin urban dhe infrastrukturë, me procedura të thjeshtuara për marrjen e lejeve dhe me transparencë më të madhe. Industria inkurajohet të adoptojë teknologji me karbon të

ulët, elektrifikim dhe zgjidhje me hidrogjen, duke përdorur mjete digjitale për konkurrencë dhe inovacion më të madh.

Sfidat e reja për energjinë

Rritja e konsumit të energjisë elektrike për shkak të digjitalizimit dhe elektrifikimit kërkon modernizimin e rrjeteve, ruajtjen dhe fleksibilitet më të madh. Nevojiten politika që sigurojnë drejtësi dhe qasje, si dhe mekanizma të rinj financiarë si obligacionet e gjelbra, partneritetet publike-private dhe financimet inovative.

Zhvillimi i qëndrueshëm, zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe arsimi

Deklarata njih rëndësinë e zgjidhjeve të bazuara në natyrë, si biomasa e qëndrueshme dhe rigjenerimi i ekosistemeve. Një theks i veçantë vihet te arsimi, trajnimet dhe rikualifikimet që do ta përgatisin forcën e punës për epokën e re energjetike. Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i të dhënave dhe praktikat më të mira janë kyçe për të përshpejtuar përparimin drejt objektivave globale energjetike dhe klimatike.

Me nënshkrimin e "Deklaratës së Shkupit", pjesëmarrësit e Forumit ftojnë publikun, qeveritë, bizneset dhe akademinë të veprojnë bashkërisht për një sistem që mbron klimën, nxit inovacionin dhe siguron prosperitet për të gjithë.



Deklarata u nënshkrua nga ministrja e energjisë Sanja Bozhinovska, përfaqësuesi i Programit për zhvillim të OKB-së, Armen Grigoryan, dhe drejtori i Divizionit për energji të qëndrueshme (UNECE), Dario Liguti

TË PUNSUARIT DHE MEPSO



Robe Robeski- e është inxhinier i elektroteknikës, me një përvojë të pasur në sektorin e elektroenergjetikës. Karrierën e tij e ka filluar në kompaninë „Mikron“ në Prilep, për të vazhduar më pas në ESM – KME Oslomej dhe në ESM – zhvillim dhe investime, Shkup. Pas ndarjes së ESM-së në vitin 2005, ai ka punuar në ESM Distribucim dhe EVN Maqedoni. Në ShA MEPSO ka mbajtur disa pozita drejtuese, përfshirë drejtues i Sektorit të trafostacioneve, kryeinxhinier në Njësinë e ORT-së (2010–2017), drejtues i Departamentit të largpërçuesve dhe drejtues i Shërbimit për sistemet AC/DC. Që nga viti 2024, është koordinator për projektet e linjave të tensionit të lartë në Kabinetin e drejtorit të ORT-së.

Gjatë karrierës së tij, ka marrë pjesë aktive në përgatitjen, projektimin dhe realizimin e projekteve elektroenergjetike për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Veçanërisht dallohet për realizimin e projekteve investuese për zhvillimin dhe modernizimin e sistemit elektroenergjetik të Maqedonisë. Ndër projektet e rëndësishme që ka udhëhequr janë ndërtimi dhe rikonstruimi i trafostacioneve 400 kV dhe 110 kV, si dhe linjave të transmetimit, duke përmirësuar kështu sigurinë, besueshmërinë dhe stabilitetin e rrjetit elektroenergjetik. Suksesi i tij i dedikohet punës ekipore dhe bashkëpunimin me ekspertët dhe shërbimet profesionale në ShA MEPSO

Biljana Prodanoviq - është matematikante e diplomuar me 23 vjet përvojë pune në ESM Maqedoni dhe në ShA MEPSO, që nga themelimi i kompanisë. Si udhëheqëse e Shërbimit për AMR/MDM, ajo menaxhon me sukses funksionalitetet e sistemit IDSpecto, i cili përfshin: AMR (Automatic Meter Reading) – mbledhje automatike e të dhënave nga matësit dhe MDM (Meter Data Management) – përpunim, ruajtje dhe menaxhim i bazave të të dhënave, me arkivë të paktën 10-vjeçare. Veprimtaria bazë është menaxhimi i sistemit IDSpecto, për të cilin Biljana ka disa trajnime: IDSpecto Basic – bazë, dhe IDSpecto administrator, me certifikata të fituara nga prodhuesi, e më vonë edhe trajnim të avancuar për menaxhim administrativ. Ky sistem ka funksionalitete të panumërta, por baza është disponueshmëria e të dhënave me nivel të lartë sigurie dhe besueshmërie për të gjithë përdoruesit. Përmes informacionit ditor WEB, ShA MEPSO siguron paraqitje të detajuara të gjendjes në sistemin energjetik sipas segmenteve: prodhim, konsumatorë direktë, rrjete distribuuese, hyrje dhe dalje, humbje në sistem, devijime etj.



Nikollaj Janev- e është teknik ndërtimi në Kabinetin e drejtorit gjeneral. Karrierën e tij profesionale e fillon në vitin 1994 në uzinën HEC „Kozjak“, në atëkohëshoqërinë aksionare ESM. Përvojën e punës e ndërton në Drejtorinë e ESM-së, në njësitin „Transmetim dhe shpërndarje“ si dhe në sektorin për Zhvillim dhe investime, ndërtim të rrjetit të tensionit të lartë. Me formimin e ShA MEPSO në vitin 2005, bëhet pjesë e njësitit ORT-së, në sektorin për inxhinieri. Gjatë karrierës së tij tredhjetëvjeçare, Janev është përfshirë në ndërtimin e të gjitha interkoneksioneve kyçe: linjës 400 kV Dubrovë-Shtip, Shtip-kufiri Maqedoni-Bullgari, Manastir-kufiri grek dhe Shtip-kufiri Maqedoni-Serbi. Po ashtu ka marrë pjesë në ndërtimin dhe sanimin e pothuajse të gjitha linjave 110 kV në Maqedoni. Me njohuritë dhe përvojën e tij, Nikollaj lë gjurmë të përhershme në

zhvillimin e infrastrukturës energjetike të Maqedonisë.

Vladimir Veljanoski- është udhëheqës i Shërbimit për kreditimin e projekteve ndërkombëtare në kuadër të Sektorit të financave të ShA MEPSO. Nga profesioni është ekonomist i diplomuar, drejtim menaxhim financiar. Karrierën e tij profesionale e fillon në vitin 2005 në sektorin bankar ku fiton përvojë të konsiderueshme në fushën e kreditimit. Që nga viti 2011 është pjesë e ekipit të ShA MEPSO ku me sukses e ndërton ekspertizën e tij në financat ndërkombëtare dhe menaxhimin e projekteve. Posedon disa certifikata për pjesëmarrje në trajnime dhe seminare nga fusha e financave, që kontribuon në profesionalizmin dhe zhvillimin e tij të vazhdueshëm profesional. Në kuadër të detyrave të punës, Vladimiri është përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin financiar të projekteve ndërkombëtare të financuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Botërore. Ndër projektet më të rëndësishme janë: projekti strategjik për lidhjen energjetike midis Maqedonisë dhe Shqipërisë; projekti për rivitalizimin e rrjetit energjetik dhe rekonstruktimin e nënstacioneve, si dhe projekti për forcimin e rrjetit të transmetimit në rajonin juglindor të shtetit.



Sonja Paunovska- me më shumë se dhjetë vjet përvojë si juriste e diplomuar, jam pjesë e ekipit të Shërbimit për eksproprijim pranë Departamentit për çështje pronësore-juridike në ShA MEPSO. Shërbimi ynë paraqet një hallkë kyçe në realizimin e projekteve strategjike energjetike, duke siguruar mbështetje juridike dhe zbatimin e procedurave të eksproprijimit, gjithmonë brenda kuadrit të rregullativës ligjore dhe me respekt për të drejtat individuale. Toka, si bazë për ndërtimin e rrjetit elektroenergjetik, kërkon marrëdhënie pronësore të qarta, ndërsa roli ynë është të sigurojmë një proces të ndershëm, transparent dhe të drejtë, në të cilin prona private trajtohet me mbrojtje të plotë juridike. Puna jonë është një balancë e vazhdueshme mes interesit publik dhe pronës private, me qëllim ndërtimin e infrastrukturës që do të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të sistemit energjetik. Përmes

angazhimit të shërbimit, ne kontribuojmë aktivisht në përmbushjen e misionit të ShA MEPSO për zhvillim të qëndrueshëm, transmetim stabil të energjisë elektrike dhe përgjegjësi shoqërore.

Janko Rusevski- është inxhinier i diplomuar në informatikë dhe udhëheqës i Shërbimit për sigurinë e rrjetëve (Head of Cyber Security Unit) në sektorin IT-TK pranë ShA MEPSO. Me mbi 19 vjet përvojë profesionale, ai është plotësisht i përkushtuar në sigurimin e një niveli të lartë sigurie, besueshmërie dhe disponueshmërie të të dhënave në fushën e sigurisë së rrjetave, mbrojtjes kibernetike dhe menaxhimit të sistemeve informative. Më parë ka punuar si Administrator sistemi me autorizime në Active Directory dhe Microsoft 365, Autodesk, VMware dhe platforma të tjera. Duke menaxhuar ekipin për siguri IT, përgjegjësitë e tij përfshijnë zbulimin dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike, zhvillimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë, monitorimin e trafikut të rrjetit, analizën e incidenteve potenciale dhe menaxhimin e përditësimit të sistemeve me ndjekje të plotë të infrastrukturës VDI që e përdorin të punësuarit në kompani. Përveç aftësive teknike, Rusevski posedon njohuri të gjera në strukturën harduerike të kompanisë dhe bashkëpunon me sukses me sektorët dhe departamentet e tjera për funksionim të papenguar të sistemeve komplekse IT në ShA MEPSO.



LAJME NGA BOTA

BULLGARIA KARBURANT I SIGURUAR DERI NË FUND TE VITIT, POR ÇFARË VJEN MË PAS?



Qeveria bullgare njoftoi se Bullgaria ka rezerva të mjaftueshme karburanti për të mbuluar të gjitha nevojat deri në fund të vitit 2025, pas shqetësimeve të ngritura nga sanksionet e reja amerikane ndaj kompanive ruse Lukoil dhe Rosneft.

Megjithatë, ekspertët theksojnë se në planin afatgjatë është thelbësore të forcohet konkurrenca dhe transparenca në tregun e karburanteve. Problemi kryesor mbetet pronësia e rafinerisë së Burgasit dhe monopoli historik i Lukoil, të cilat e lënë tregun të ekspozuar dhe të brishtë. Sanksionet amerikane kufizojnë financimin e këtyre kompanive, ndërsa çdo bashkëpunëtor me to rrezikon të goditet nga sanksione sekondare.

«Kemi rezerva deri në fund të vitit dhe, me planifikim të kujdesshëm dhe me reformat e nevojshme, sektori mund të bëhet më rezistent dhe më efikas», deklaroi analisti Georgi Kirjakov.

Qeveria dhe kompanitë tashmë po ndërmarrin hapa për diversifikimin e burimeve të furnizimit, duke krijuar bazën për një treg më të qëndrueshëm dhe për siguri energjetike gjatë vitit të ardhshëm.

[\(Bugarska ima goriva do Nove godine – a posle? - Energija Balkana\)](#)

SUEDIA PËRFITON PARKUN E PARË HIBRID PËR ENERGJINË DIELLORE TË ERËS

European Energy, një kompani daneze e specializuar në burime të rinovueshme të energjisë, hapi parkun e saj të parë hibrid në provincën Kronoberg të Suedisë. Parku i ri kombinon një kapacitet erë të 49,6 MW me tetë turbina dhe një park diellor me 39,3 MWp, me një prodhim vjetor prej rreth 126 GWh – të mjaftueshëm për të furnizuar me energji më shumë se 25.000 amvisëri.

«Kombinimi i diellit dhe erës lejon një prodhim më të barabartë: dielli shkëlqen më shumë gjatë ditës dhe verës, ndërsa era fryn më fort natën dhe në periudhën dimërore», tha Peter Braun, Menaxheri i European Energy në Suedi.

Projekti është ndërtuar me kujdes të madh ndaj mjedisit: janë ruajtur pellgjet e ujit, janë krijuar

habitatet natyrore për speciet e egra të kafshëve, dhe janë mbjellë bimë miqësore për bletët dhe pjalmuesit e tjerë.

Skaramala është parku i parë nga tre parqe hibride të planifikuara në Suedi. Projekti i ardhshëm është Grevekulla, i cili tashmë është në ndërtim e sipër.



[\(https://europeanenergy.com/2025/09/26/european-energy-inaugurates-its-first-hybrid-park-with-solar-and-wind-power/\)](https://europeanenergy.com/2025/09/26/european-energy-inaugurates-its-first-hybrid-park-with-solar-and-wind-power/)

EFIKASITETI ENERGJETIK: ENERGJI E ZGJATUR PËR NJË JETË MË TË MIRË

Imagjinoni një botë ku dritat ndizen pa humbje, faturat e energjisë elektrike janë më të ulëta dhe vendet e reja të punës lindin si me magji. Kjo është realiteti që ofron efikasiteti energjetik. Dy të tretat e energjisë botërore shpërdorohen kot, por me investimet e duhura, çdo dollar i shpenzuar për efikasitet energjetik mund të kthejë tre deri në pesë



dollarë, duke krijuar rritje ekonomike, vende të reja pune dhe standard më të lartë jetese. Banka Botërore paralajmëron se për të shfrytëzuar plotësisht këtë potencial nevojitet veprim i menjëhershëm dhe i përbashkët. Qeveritë, donatorët dhe sektori privat duhet ta vendosin efikasitetin energjetik si prioritet, duke siguruar mbështetje teknike dhe financiare për programet kombëtare. Turqia është një shembull se si kjo mund të ketë sukses: qindra ndërtesa publike, nga shkollat te spitalet, janë rinovuar, me kursime të mëdha energjetike, përmirësim të kushteve të punës dhe mundësi të reja për trajnim e punësim.

Efikasiteti energjetik nuk është vetëm koncept ekonomik; është mundësi për energji më të lirë, më shumë vende pune dhe jetë më të mirë për miliarda njerëz në të gjithë botën.


(<https://www.worldbank.org/en/news/feature/2025/07/11/energy-efficiency-fast-tracking-affordable-energy-and-jobs>)

MENAXHIMI I INTEGRUAR I ENERGJISË DHE UJIT DO T'Ë RRISË KURSIMET NË INDUSTRI

Bota po përballë me një problem serioz me ujin, ndërsa industria mund të jetë pjesë e zgjidhjes. Gjysma e popullsisë botërore përjeton mungesë uji në një pjesë të vitit, ndërsa industria është përdoruesi i dytë më i madh i ujit të freskët dhe konsumatori më i madh i energjisë. Edhe pse uji dhe energjia shpesh menaxhohen veçmas, qasja e integruar mund të ulë humbjet dhe shpenzimet, të krijojë vende të reja pune dhe të zvogëlojë emetimet e gazrave. Ulja e konsumit të energjisë do të thotë edhe kursim uji, ndërsa përdorimi racional i ujit e zvogëlon nevojën për energji për prodhim dhe transport.

Kompanitë mund të përdorin ujë procesi ose ujëra të trajtuara të zeza, duke ulur kështu konsumin e ujit të freskët dhe kostot energjetike. Qeveritë dhe agjencitë e energjisë ftohen të zbatojnë politika të integruara, trajnime dhe auditime, me qëllim që të zbulohen

Figure P.2 Increase in water withdrawals for different sectors, 1960–2014




Source: Otto and Schleifer (2020).

përfitimet e efikasitetit energjetik dhe ujqor dhe të nxitet funksionimi i qëndrueshëm i industrisë.

(<https://www.iea.org/commentaries/integrated-energy-and-water-management-will-boost-savings-in-industry>)



20MEPSO
VJET



**RRJETI STABIL,
ENERGJIA E SIGURT**

WWW.MEPSO.COM.MK

OPERATOR I SISTEMIT ELEKTROTRANSMETUES